

## STATUT

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “ELBAFRUIT ” SHPK

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **“ELBAFRUIT ” SHPK**, eshte themeluar nga ortaku i vetem Z. Aleksander Hoxha, atesia Hasan, lindur me 24.06.1983 , mbajtes i leternjoftimit nr.028067025, numer personal I30624015M, banues ne lagja “Sul Papri ”, Elbasan, madhor me zotesi te plete juridike e per te vepruar; ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise nr. 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar dhe ligjt 9723 date 03.05.2007 ”Per QKB”, te ndryshuar.

#### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Neni 1

Shoqeria eshte person juridik i se drejtes shqiptare dhe gezon te drejtat e personit juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Bizneseve. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje te plete me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e aktit te themelimit e te ketij statuti.

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Neni 2

Objekti i veprimtarise i Shoqerise **“ELBAFRUIT” SHPK** do te jete:

- Prodhim perpunim, shperndarje fruta perime dhe eksport produktesh. Import eksport i te gjitha llojeve te mallrave industriale, ushqimore, tregtim i tyre me shumice dhe me pakice. Zhvillim i cdo aktiviteti tregtar e financiar qe i sherben realizimit te objektit te aktivitetit. Import eksport dhe tregtim te mallrave te akcizes. Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e pakice te ushqimeve per njerez me origjine shtazore. Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e fruta perimeve, paketimi i tyre dhe eksportimi.

#### **SELIA E SHOQERISE**

Neni 3

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **“ELBAFRUIT” SHPK**, ka seline e saj ne Elbasan , ne nr. Pasurie 666/5; zona kadastrale 8526, lagja Fushe Ure, Elbasan. Shoqeria mund te kryeje e te transferoje, apo te suprimoje qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit.

#### **KOHEZGJATJA**

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete pa afat, me mundesine e zgjatjes apo te shkurtimit te afateve, te ndryshoje veprimtarine, emertimin, seline, objektin e veprimtarise sipas vendimit te ortakeve te shoqerise.

#### **DETYSRIMET E ORTAKEVE**

Neni 5

Ortaku i vetem i shoqerise duhet te kryeje depozitim e kapitalit themeltar per llogari te shoqerise ne nje banke te caktuar prej tij.

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Aleksander Hoxha".



## **TRANSFERIMI I KUOTAVE**

Neni 6

Ortaku i vetem mund te kaloje pjesen nga kapitali themeltar i personave te tjere ne perputhje me rregullat e parashikuara ne nenin 73 te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

## **PARAQITJA KONTABILE**

Neni 7

Operacionet e shoqerise kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit te parashikuara ne legjislacionin shqiptar dhe paraqitjen me saktesi ne bilancin vjetor te aktivitetit.

Ne mbyllje te cdo viti ortaku i vetem ose personi i ngarkuar prej tij, ben inventarizimin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin dhe harton raport me shkrim. Ky raport pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit finanziar.

## **KAPITALI THEMELTAR**

Neni 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2 000 000 (dy milion) leke. Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tij si vijon :

Lloji i kontributit eshte ne para ne vleren 2 000 000 (dy milion) leke, i ndare ne 1 kuot ne vleren 2 000 000 (dy milion) leke, e cila perben 100% vleren e kapitali themeltar.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte shlyer dhe nenshkruar teresisht nga ortaku i shoqerise.

## **OPERACIONET FINANCIARE**

Neni 9

Shoqeria eshte e autorizuar per te siguruar mjete financiare dhe kredit duke ju drejtuar bankave, institucioneve te kreditit ose atyre te financimeve totale apo te jashtme, institucioneve nderkombetare te financimit dhe te kreditit sido qe te jete percaktuar.

## **BLERJET E SHOQERIVE**

Neni 10

Shoqeria disponon mjetet e saj ne perputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e shoqerise. Ne Republiken e Shqiperise, shoqeria gezon te drejten e saj per te zoteruar mjete te saj si ne cdo shoqeri tjeter ose organizate tregtare, kombetare shqiptare ne perputhje me Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

## **FONDI REZERVE**

Neni 11

Shoqeria mund te themeloje nje fond rezerve si dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin e tij.

Perberja, shuma totale, fondet per krijimin e tyre perdorimi dhe rregullimi i tyre (i cdo fundi) percaktohet nga ortaku i vetem ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale te shoqerise raportohen ne bilance te shprehur ne leke shqiptare, ne perputhje me rregullat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Bilanci dhe perllogaritjet ekonomike te shoqerise hartohen mbi bazen e formes se bilancit dhe llogaritjeve ekonomike te percaktuara per shoqerite tregtare ne Shqiperi. Bilanci vjetor mbyllte ne 31 dhjetor te cdo viti.

Aleksandër Hoxha 



## PLANET FINANCIARE

Neni 12

Aktiviteti i shoqerise mbi bazen e programeve financiare qe bejne pjese ne aktivitetin financiar te saj. Planet financiare parashikojne koston dhe te ardhurat e shprehura ne leke shiptare. Gjendja pasurore dhe llogaritjet ekonomike do te paraqiten ne leke shqiptare. Rezultatet financiare te aktivitetit dhe te punes se kryer nga shoqeria, paraqiten ne bilancin vjetor. Kursi i kembimit te monedhes shqiptare ne monedhat e huaja dhe e kunderta do te jene ato te vendosura nga Banka e Shtetit Shqiptar.

## ORGANET E SHOQERISE

Neni 13

Organ vendimmarres i shoqerise **"ELBAFRUIT" SHPK** eshte asambleja e ortakeve e perbere nga ortaku i vetem z. Aleksander Hoxha. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij nenit, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkates. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm registrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistraura në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Neni 14

Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901, date 14.04.2008, nga ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e

Aleksander Hoxha



kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

## MËNYRA E THIRRJES

Neni 15

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS

Neni 16

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- është i autorizuar të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përbushin kërkuesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 14 te statutit.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesat e tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

## PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

Neni 17

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## KUORUMI

Neni 18

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme

Aleksandës Hoxha

duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit '9901, date 14.04.2008 , ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## MARRJA E VENDIMEVE

Neni 19

Me përashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit per shoqerite tregtare, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrimë shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

## PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Neni 20

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbal duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbal i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

## ADMINISTRATORI

Neni 21

Shoqeria me perjegjesi te kufizuar administrohet nga një ose disa persona fizike. Administratori i shoqerise emerohet me vendim te ortakut te shoqerise. Afati i qendrimit ne detyre i administratorit te shoqerise eshte per një periudhe 5 (pese) vjecare.

Administrator i kesaj shoqerie eshte z. Aleksander Hoxha.

Administratori i shoqerise i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrëthanat, me perjashtim te kompetencave qe u njeh ligji shprehimisht Asamblese se Ortakeve ose te treteve.


Administratori ka perjegjesi ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkeljete ligjeve, statutit apo shkeljeve te kryera gjate administrativit. Administratori ne rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogarite vjetore etj.

## RASTET E PUNES

Neni 22

Raportet e punes ndermjet shoqerise, filialeve dhe agjensive te saj si dhe te punonjesve ne te, rregullohen ne baze te kontrates se punes, konform Kodit te Punes.

Aleksander Hoxha



Per sa nuk parashikohet ne kontraten e punes, aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 23

Shoqeria merr persiper, te shlyeje rregullisht te gjitha detyrimet e saj qe burojne nga legjislacioni per sigurimet shoqerore e shendetesore lidhur me te punesuarit e saj.

## **PERFUNDIMI I AKTIVITETIT**

Neni 24

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar prishet:

- 1.Me kalimin e afatit per kohezgjatjen e saj ne kontraten e themelimit.
- 2.Per pamundesine e realizimit te objektit te saj.
- 3.Me vendimin e gjykates.
- 4.Me hapjen e procedurave te falimentit.

## **LIKUJDIMI**

Neni 25

Likujdimi i shoquerise me pergjegjesi te kufizuar do te behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne kohen e likujdimit.

## **KUSHTET E TJERA**

Neni 26

Te gjitha vendimet e mara nga asambleja e ortakut te veten evidentohen ne nje liber te vecante, i cili administrohet ne seline e shoquerise.

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht dhe saktesisht ne kete, statut do ti referohen plotesimeve qe mund te beje ortaku I vetem si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Ky statut firmoset rregullisht

Per shoqerine tregtare **“ELBAFRUIT” SHPK” SHPK**

Ortaku i vetem **Aleksander Hoxha**.

Elbasan, me 24/05/2021





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER FATMIR Y. KOSENI**



V2021010740113463744

**DATE 24/05/2021  
NR REP 2486**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 24.05.2021, para meje Noter FATMIR Y. KOSENI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Elbasan, AQIF PASHA/NR.4, 28 NENTORI, NR.6/307, u paraqit personalisht:

**DEKLARUES:**

Aleksander Hoxha, atësia Hasan, amësia Lutfije, shtetas Shqiptar, lindur në Floq, Elbasan dhe banues në Elbasan, lindur më 24/06/1983, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035023242 dhe nr. personal I30624015M .

**Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noterit, Akt Themelin e shoqerise “ELBAFRUIT” SHPK dhe Statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “ELBAFRUIT” SHPK , bashkëlidhur.**

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërrma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

FATMIR Y.T. KOSENI

*Taksë e Pullës  
U Pagua*

